1.2.	Praktika inkluzive	3x15x4x0.04=7.2
1.3.	Vështirësitë në të mësuar	2x15x4x0.04=4.8
1.4.	Pedagogji speciale	2x15x5x0.04=6
1.5.	Metodologji e hulumtimeve në edukim special dhe rehabilitim	2x15x3x0.04=3.6
1.6.	Metodologji e hulumtimeve pedagogjike (klasor)	2x15x3x0.04=3.6
1.7.	Metodologji e hulumtimeve pedagogjike (profesional)	2x15x3x0.04=3.6
1.8.	Didaktikë e nxënësve me nevoja të veçanta	2x15x5x0.04=6
1.9.	Metodikë e fëmijëve me pengesa në zhvillim	2x15x5x0.04=6
1.10.	Bashkëpunimi shkollë familje	2x15x1x0.04=1.2
1.11.	Sistemet Arsimore	3x15x1x0.04=1.2
1.12.	Metodologji joeksperimentale /Psikologji - Tetovë	2x15x1x0.04=1.2
	Metodologji joeksperimentale /Psikologji – Shkup	2x15x1x0.04=1.2
2.	Mbajtja e ligjeratave (lëndët në ciklin e dytë të studimeve)	
2.1.	Metodologji /Programi studimor në psikologji	4x15x0.05=1.5
	Evalumi i kurikulës / pedagogji	2x15x0.05=1.5
	Metodologji e hulumtimeve pedagogjike	2x15x3x0.05=4.5
	Arsimi inkluziv	2x15x3x0.05=4.5
3.	Konsultimet me studentët	Pikët
3.1.	Hyrje në edukim special dhe rehabilitim	200 x 0.002=0.4
3.2.	Praktika inkluzive	200 x 0.002=0.4
3.3.	Vështirësitë në të mësuar	100 x 0.002=0.2
3.4.	Pedagogji speciale	300 x 0.002=0.6
3.5.	Metodologji e hulumtimeve në edukim special dhe rehabilitim	100 x 0.002=0.2
3.6.	Metodologji e hulumtimeve pedagogjike (klasor-profesional)	300 x 0.002=0.6
3.7.	Didaktikë e nxënësve me nevoja të veçanta	100 x 0.002=0.2

	Metodikë e fëmijëve me pengesa në	
3.8	Metodikë e fëmijëve me pengesa në zhvillim	300 x 0.002=0.6
3.9	Bashkëpunimi shkollë familje	35 x 0.002=0.07
3.10	Sistemet Arsimore	35 x 0.002=0.07
3.11	Metodologji joeksperimentale /Psikologji - Tetovë	100 x 0.002=0.2
3.12	Metodologji joeksperimentale /Psikologji – Shkup	35 x 0.002=0.07
	Përgatitje për lëndë të re / ligjërata	
1	Hyrje në edukim special dhe rehabilitim	1
2	Praktika inkluzive	1
3	Vështirësitë në të mësuar	1
4.	Mentor i punës së diplomës	65x0.2=13
5.	Anëtar i komisionit për vlerësim ose mbrojtje të magistraturës	23x1=23
6.	Anëtar i komisionit për vlerësim ose mbrojtje të punimit të diplomës	15x0.2= 3
7.	Mentor i mbrojtjes së temës së magistraturës	14x3=42
8.	Skriptë interne per ligjërata	4x4=16
10.29	Viziting profesor	10x8=80
	Gjithsej	242.21

VEPRAMTARIA HULUMTUESE –KËRKIMORE

Nr. rend	Emri i aktivitetit:	Pikët
1.	Mentor i punimit të magistraturës	14x2=28
2.	Pjesëmarrës në projekt kombëtar shkencor	1x3=1
3.	Punim me rezultate origjinle shkencore, i publikuar në reviste profesionale shkencore me redaktim ndërkombëtar	1x6=6
4.	Punim me rezultate origjinle, i publikuar në revistë profesionale shkencore me redaktim nderkombetar	4x4=12
5.	Punim me rezultate origjinle, i publikuar në përmbledhje të punimeve shkencore nga nje tubim ndërkombëtar	1x2=2
6.	Punim me rezultate origjinle, i publikuar në përmbledhje të punimeve shkencore nga nje tubim shkencor me redaktim ndërkombëtar	3x3=9
7.	Pjesmarrje ne takim profesional me referat – prezentim oral	9x2=18
8.	Apstrakt i publikuar në përmbledhje të konferencës ndërkombëtare	10x1=10
9	Ligjeratë plenare në tubim shkencor me pjesmarrje ndërkombetare	3
	Gjithsej	89

VEPRIMTARIA PROFESIONALE-APLIKATIVE

Nr. rend.	Emri i aktivitetit:	Pikët
-----------	---------------------	-------

1.	Tekst nga fusha profesionale - autor	3x8=24
2.	Recenzent i librit	1x1=1
	Redaktim profesional	3x4=12
3.	Kordinator i përgatitjes së elaboratit për program të ri studimor	1x2=2
	Вкупно	39

VEPRIMTARIA ME INTERES TË GJËRË

Nr.rend.	Emri i aktivitetit:	PIKËT
1.	Anëtar i këshillit redaktues të revistes profesionale	4x1=4
	Anëtar i këshillit organizativ në tubim shkencor ndërkombëtar	5x2=10
2	Prodekan	4
4.	Udhëheqës	3
6	Anëtar i komisionit në Universitet	3x1=1
7.	Anëtar i komisionit në Fakultet	1
8.	Anëtar i komisionit për zgjedhje në thirrje	1x0.5=0.5
10.	Udhëheqës i studimeve pasdiplomike	2
	Fitues i çmimit ndërkombëtar për arritje shkencore	5
	Gjithsej	30.5

REFERENCAT PROFESIONALE TË KANDIDATIT PËR ZGJEDHJEN NË THIRRJEN	PIKËT
VEPRIMTARIA MËSIMORE-ARSIMORE	242.21
VEPRIMTARIA SHKENCORE-HULUMTUESE	89
VEPRIMTARIA PROFESIONALE-APLIKATIVE	39
VEPRIMTARIA ME INTERS MË TË GJËRË	30.5
GJITHSEJ	400.71

Komisioni recensues

1. Prof. Goran Ajdinski, profesor ordinar në Universitetin Shën Kirili e Metodi në Shkup, (kryetar)
2. Prof. dr. Dragoslav Kopačev, profesor ordinar në Universitetin Shën Kirili e Metodi në Shkup, (anëtar)
3. Prof. dr. Fadbi Osmani, profesor ordinar në Universitetin e Tetovës në Tetovë, (anëtar)

Deri te:

Këshilli i Rektoratit i Universitetit të Tetovës

Në bazë të propozimit të Këshillit Mësimor-Shkencor të Fakultetit Pedagogjik, të Universitetit të Tetovës, nr. 24-113/1, lidhur me Konkursin, për zgjedhjen/rizgjedhjen e mësimdhënësve në thirrje mësimore-shkencore, të shpallur në të përditshmet “Koha” dhe “Nova Makedonija” të datës 31.01.2018, si dhe në web-faqen e Universitetit www.unite.edu.mk, Këshilli i Rektoratit, në mbledhjen e mbajtur më 27.02.2018 solli vendim për formimin e Komisionit recensues nr. 02-1139/1, në përbërje:

1. **Prof.dr. Fehim Huskoviç (kryetar)-Profesor i rregullt në Fakultetin e Artit Figurativ në Shkup**
2. **Prof.ord. Reshat Ameti (anëtar)- Profesor i rregullt në Fakultetin e Artit Figurativ të Universiteti të Tetovës**
3. **Prof. dr. Fadbi Osmani (anëtar)- Profesor i rregullt në Fakultetin Pedagogjik të Universitetit të Tetovës**

Në konkursin për mësimdhënës për lëndët: **Didaktika e artit figurativ I,II, Loja Skenike, Histori Arti** është paraqitur një kandidat, edhe atë :

1. Dr.sc. Valentina Pajaziti

Komisioni recensues, pasi e kontrollloi materialin e konkursit, titullit të lartpërmendur i paraqet këtë:

R E F E R A T

I. Të dhënat biografike, përgatitja profesionale-shkencore dhe aktiviteti pedagogjik

Dr.sc. Valentina Pajaziti lindi më 11.11.1975 ne Pejë, Kosovë. Shkollën fillore e mbaroi në vendlindje dhe shkollën e mesme të artit "Odhise Paskali", dega-Dizajn tekstil, i mbaroi në Pejë më 1994.

Më pas, vazhdoi me studimet deridiplomike në Akademinë e Arteve në Tiranë, në degën Dizajn tekstil, nën udheheqjen e Prof. Najada Hamza, në 1994-1998 dhe i përfundoi me notë mesatare 8.3. Në vitin 2009 mbaroi Magjistraturën në Prishtinë, Republika e Kosovës, nën mentorim të Prof. Zake Prelvukaj ne Pikturë me temën “Emocionet si motivim artistik” me notë mesatare 9.5.

Në vitin 2017 mbaroi doktoraturën në Novi Pazar-Republika e Sërbisë, nën metorim të Prof.dr. Fehim Huskoviç me temën “Estetski principi u metodologiji nastave”(Parimet estetike në metodologjinë e mesimdhënies) me notë mesatare 9.4.

Në vitin 2002/2003 deri ne vitin 2004 punoi si profesoreshë e artit figurativ në shkollën e mesme ekonomike në Tetovë, më pas në vitin 2004/2005 deri më 2005/2006 në Gjimnazin e Tetovës, po ashtu si profesoreshë në lëndën e Artit figurativ. Në vitin 2006/2007 punoi si profesoreshë në shkollën e mesme tekstile në Tetovë në lëndën Dizajn tekstil.

Në vitin akademik 2007/08 punësohet në marrëdhënie të rregullt pune si Asistente e re, në Universitetin Shtetëror të Tetovës, pranë Fakultetit Filozofik, departamenti: Pedagogji, duke përfaqësuar ushtrimet në lëndët mësimore: Medodika e artit figurative I,II , ku në vitin 2011/12 përfaqëson ligjeratat dhe ushtrimet në lëndët: Medodika e artit figurative I,II, Vizatim; më pas në vitin 2013/2014 angazhohet me lëndët: Didaktika e artit figurativ I,II, Loja Skenike, Historia e Artit. Në vitin 2015/16 angazhohet për lëndët: Skenografi, Kostumografi pranë Fakultetit të Arteve Figurative dhe atë Dramatik.

Dr.sc.Valentina Pajaziti përveç punës si mësimdhënëse, ka qenë e angazhuar edhe në punën e saj profesionale si artiste- kostumografe në dramat:

- „IMPREZARI NGA IZMIRI“, organizuar nga Ministria e Kulturës së Republikës së Maqedonisë më 2008 në Tetovë.
- „ALEGRETTO ALBANIA“, organizuar nga Ministria e Kulturës së Republikës së Maqedonisë si dhe Cosmofon më 2007 në Shkup.
- „VDEKJA AKSIDENTALE E NJË ANARKISTI“, organizuar nga Ministria e Kulturës së Republikës së Maqedonisë më 2008 në Tetovë.
- „ÇMENDINA“, organizuar nga Ministria e Kulturës së Republikës së Maqedonisë më 2006.
- „DASHURI, TEATËR DHE MARRËZI TË TJERA“, organizuar nga Ministria e Kulturës së Republikës së Maqedonisë më 2012.
- „ME GRUSHT TEHUT TË THIKËS“, organizuar nga Ministria e Kulturës së Republikës së Maqedonisë më 2013.

Gjithashtu, Valentina Pajaziti në kuadër të fushës së saj profesionale ka realizuar edhe sfilatë mode (e para në këtë fushë arti) në vitin 2005, në të cilën kishte pesëmbëdhjetë modele të ndryshme me përmbajtje artistike *Rilindja*, ku nuk mungoi luksi dhe ekstravaganca. Në vitin 2011 për herë të parë hapi ekspozitën e saj vetanake në Tetovë me titull *Emocionet si motivim artistik*. Si artiste, në veprimtarinë e saj krijuese gërsheton lëmi të ndryshme të artit pamor, fotografi, piktura, tapiceri, vizatime, instalacione me një karakter të fortë shpirtëror. Motivi bazë i Valentinës janë femrat dhe këto të fundit trajtohen në kategoritë emocionale si: trishtimi, hidhërimi, gëzimi, zhgënjimi, lumturia, ankthi etj. Valentina është poashtu, Anëtare e Shoqatës së Artistëve në Tetovë. Është aktive me pjesëmarrje në ekspozita të ndryshme.

- Ekspozita „SALLONI PRANVEROR“ Gostivar – 2013, organizuar nga Ministria e Kulturës së Republikës së Maqedonisë.
- „SALLONI DIMËROR“ Tetovë 2007, organizuar nga Ministria e Kulturës së Republikës së Maqedonisë.
- Pjesëmarrje në ekspozitë me rastin e 8 Marsit, Tetovë 2016 organizuar nga Komuna e Tetovës
- Pjesëmarrje në ekspozitë me rastin e „28 NËNTORIT“ 2015 organizuar nga Komuna e

Tetovës

- Ekspozitë personale: „EMOCIONET SI MOTIVIM“ më 2011, me vetëfinansim.
- Realizuese e sfilatës së parë të modës në Tetovë me temën:
„LUKS DHE EKSTRAVAGANCË” më 2005 vetëfinansim.
- Ekspozitë: „REFLEKSION 2009“ Prishtinë, organizuar nga Ministria e Kulturës së Republikës së Kosovës.
- Ekspozitë: „TEKSTIL '98“ Tiranë, më 1998.
- Ekspozitë: „PRANVERA 95 “, Albaned - Galeria Kombëtare e Arteve në Tiranë.

Gjithashtu, në kuadër të punës së saj në Fakultetin Pedagogjik Dr.sc.Valentina Pajaziti ka qenë në komisione, mentorim dhe mbrojtje të temave të diplomës për studentët në ciklin e parë të studimeve.

Nga fusha e botimeve profesionale Dr.sc. Valentina Pajaziti, ka të realizuara disa dispensa për nevojat e studentëve, edhe atë:

- Loja Skenike, 2014.
- Histori Arti, 2014.
- Vizatim, 2010.
- Skenografi, 2013.
- Kostumografi, 2013.

Përgjatë rrugëtimit si mësimdhënëse Valentina ka marrë trajtime të tjera siç janë:

- Më 2004 pjesëmarrëse në projektin AKTIVITETE EKSTRAKURRIKULARE PËR SHKOLLA ME NXËNËS ETNIKISHT TË PËRZIER, organizuar nga Ministria e Kulturës së Republikës së Maqedonisë.
- Më 2005 pjesëmarrëse në projektin „КРЕАТИВНА НАСТАВА И УЧЕЊЕ“, organizuar nga USAID.
- Më 2007 pjesëmarrëse në projektin „ПРОЕКТОТ ЗА МОДЕРНИЗАЦИЈА НА ОБРАЗОВАНИЕТО“, Англиски јазик за наставници „Врата кон нови знаења“, organizuar nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës në Tetovë.
- Në vitin 2012 ka të kryer kursin e gjuhës angleze (për përgatitje të TOEFL) në UEJL (Language center) në Tetovë.

Dr.sc.Valentina Pajaziti veçohet me kontributin e saj në fushën e shkencës së hulumtimit me punimet dhe publikimet e saja në revistat ndërkombtare të cilat numërojmë poshtë.

Nga 24-25 maj 2013, ka marrë pjesë në Konferencën Ndërkombëtare Shkencore:

„RESEARCH AND EDUCATION-CHALLENGES TOWARDS THE FUTURE (ICRAE 2013)“ në Shkodër – Shqipëri, si autore me punimin shkencor të botuar në formë elektronike (<http://icrae2013.unishk.edu.al/icraecd2013/abstract.html>),

„Rëndësia e artit figurativ në edukimin estetik tek fëmijët“ dhe si bashkëautore me punimin: „The human rights situation in the Republik of Macedonia as a precondition for EU membership“. ISSN: 2308-0825

Nga 18-19 tetor 2013 ka marrë pjesë në Konferencën Ndërkombëtare Shkencore të Fakultetit Filozofik pranë Universitetit Shtetëror të Tetovës me temën „PROBLEMET SOCIO-KULTURORE DHE SFIDAT E BASHKËKOHËSISË“, me punimin shkencor:

„Filozofia e instalacionit në artin bashkëkohor“, dhe si bashkëautore me punimin:

„Vlerësimi formativ dhe ndikimi i informatës kthyesë në suksesin dhe të arriturat e nxënësve“.

Më 09 maj 2014 ka marrë pjesë në Konferencën e katërt ndërkombëtare „Shkenca dhe zhvillimi shoqëror“, organizuar në Shkup në Universitetin Europian, si autore me temën:

- „Fashion and design as challenge in science“

ISBN 978-608-4574-62-0 (Botuar në formë elektronike).

Konferencën Ndërkombëtare organizuar nga të Fakultetit Filozofik pranë Universitetit Shtetëror të Tetovës 2016 “SFIDAT DHE PERSPEKTIVA E ARSIMIT BASHKËKOHOR“ 30-31 Tetor 2015, Tetovë, R.e Maqedonisë me punimin shkencor: ”Freedom Of Aesthetic Education In Additional And Encouragement Creative In Teaching”(botuar në revisten shkencore PHILOSOPHICA Tetovë-2016).

Konferencën Ndërkombëtare Shkencore të Fakultetit Filozofik pranë Universitetit Shtetëror të Tetovës, “BALLAFAQIMI ME TË KALUARËN DHE RIMENDIMI I PAQËS NË BALLKANIN MULTIKULTUROR“, me punimin“Karakter i Socio-Estetik i Pikturës“

17-18 Tetor 2014, Tetovë, R.e Maqedonisë (botuar në revisten shkencore PHILOSOPHICA Tetovë-2015).

Konferencën Ndërkombëtare Shkencore pran Universitetit të Shtipit, „EDUCATION IN XXI CENTURY-CONDITIONS AND PERSPECTIVES“ ku kam marrë pjesë me punimin shkencorë; “Aesthetic education of educators as a future challenge” 24-25 Shtator 2015, Shtip, R.e Maqedonisë. International Stiençific Conference at the Faculty of Educational sciences

Revistë Shkencore Ndërkombtare, Qendra për mirëkuptim dhe bashkpunim institucional, QMBI, CENTRUM, 7/2017. (botuar në revisten CENTRUM si dhe online) Me punimin, “Postmodernizmi dhe simbioza e modës dhe dizajnit në instalacion”

Konferencën Ndërkombëtare Shkencore në Budva, Mali Zi, 2017
THE TEACHER OF THE FUTURE ku kam marrë pjesë me punimin shkencorë; “Apparel as attractiv aesthetic element in teaching” (botuar në revisten shkencore KNOWLEDGE si dhe online)

Kandidatja në fjalë bashkë me fletë aplikimin ka dorëzuar edhe: Vendimin e zgjedhjes Asistent i ri; Diplomën e Studimeve deridiplomike; Diplomën e Magjistraturës; Diplomën e Doktoraturës dhe vendimin e nostrifikimit nga MASH, Çertifikatën e notave për studimet deridiplomike; Çertifikatën e notave të studimeve të cikli të dytë; CV akademike; Listën e punimeve shkencore të botuara së bashku me kopje të ballinave të revistave dhe faqeve të punimeve; Kopje të certifikatave nga pjesëmarrja në Konferenca Ndërkombëtare dhe librave të abstrakteve; Kopje origjinale të punimit të Doktoraturës; Çertifikatë e Nënshetësisë dhe çertifikatë lindjeje, Vërtetim për Marrëdhënie të rregullt pune; Vërtetim për njohjen e gjuhës angleze .

PROPOZIM - VENDIM

Komisioni recensues, pas shqyrtimit të dokumentacionit të kandidatit- konkurrent, duke u mbështetur në vlerësimet e paraqitura në këtë referat, si dhe duke i marrë për bazë mbindërtimin dhe përvojën profesionale të kandidates, ka nderin që Këshillit të Rektoratit të UT-së, t'i propozojë që **Dr.sc. Valentina Pajaziti** të zgjidhet **docent** për lëndët : **Didaktika e artit figurativ I;II, Histori Arti**, dhe **Loja Skenike**.

Komisioni recensues vlerëson se kandidatja në fjalë ka kualitete shkencore dhe profesionale, i plotëson të gjitha kriteret shkencore dhe e profesionale të parapara me Ligjin për arsim të lartë, Statutin e UT-së, Rregulloren për kriteret dhe procedurën për zgjedhje në thirrjet mësimore-shkencore dhe thirrje të bashkëpunëtorëve, dhe aktet tjera normative, për t'u zgjedhur në këtë thirrje mësimore-shkencore.

Tetovë,

Data; 19.03.2018

Anëtarët e Komisionit recensues:

Prof.dr. Fehim Huskoviç (kryetar)

Prof.ord. Reshat Ameti (anëtar)

Prof.dr. Fadbi Osmani (anëtar)

S H T O J C Ë

PËR RAPORTIN PËR ZGJEDHJEN NË THIRRJEN MËSIMORE-SHKENCORE, SHKENCORE DHE MËSIMORE-PROFESIONALE

Kandidati: Valentina Pajaziti

Institucioni: Fakulteti Pedagogjik-UT Tetovë

Lëmia shkencore: Art

VEPRIMTARIA MËSIMORE-ARSIMORE

Nr.	Emri i aktivitetit:	Pikët
1.	Mbajtja e ligjëratave (lëndët në ciklin e pare të studimeve)	
1.1.	Metodika e artit figurative I, 2+2,4 (semestra)	4x15x4x0.04=9.6
1.2.	Metodika e artit figurative II, 2+2,3 (semestra)	4x15x3x0.04=7.2
1.3.	Skenografi Kostumografi, 2+0, 2 (semestra)	2x15x2x0.04=2.4
1.4.	Skenografi I, 2+0, 3 (semestra)	2x15x3x0.04=3.6
1.5.	Skenografi II, 2+0, 3	2x15x3x0.04=3.6
1.6.	Kostumografi 2+0, 1 (semestra)	2x15x1x0.04=1.2
1.7.	Loja skenike 2+0, 4 (semestra)	2x15x4x0.04=4.8
1.8.	Histori arti 2+0, 4 (semestra)	2x15x4x0.04=4.8
1.9.	Didaktika e artit figurativ I, 2+2, 4 (semestra)	4x15x4x0.04=9.6
1.10	Didaktika e artit figurative II, 5 (semestra)	4x15x5x0.04=12
1.11	Vizatim 2+1, 3 (semestra)	3x15x3x0.04=5.4
1.1.2	Mbajtja e ushtrimeve (lënda në ciklin e parë të studimeve)	
1.1.3	Metodika e artit figurative I, 2+2, 4(semestra)	2x15x4x0.04=4.8
1.1.4	Metodika e artit figurativ II, 2+2, 3	2x15x4x0.04=4.8
1.2.1	Konsultime me studentë	
1.2.2	Metodika e artit figurative (pedagogji-mësimi klasor) 2+2,4 (semestra)	25x4x0.002= 0.2
1.2.3	Vizatim (pedagogji-mësimi klasor)-2+1, 3 (semestra)	20x4x0.002=0.16
1.2.4	Skenografi Kostumografi, 2+0, 2 (semestra)(F.Arteve Dramatike)	3x4x0.002=0.024
1.2.5	Skenografi I, 2+0, 3 (semestra),(F.Arteve figurative)	5x4x0.002=0.04
1.2.6	Skenografi II, 2+0, 3 (semestra),(F.Arteve figurative)	7x4x0.002=0.056
1.2.7	Kostumografi 2+0, 1 (semestra)	2x4x0.002=0.016
1.2.8	Loja skenike 2+0, 4 (semestra)(pedagogji-klasor dhe professional)	25x4x0.002=0.2
1.2.9	Histori arti 2+0, 4 (semestra) (pedagogji-klasor dhe professional)	25x4x0.002=0.2
1.2.10	Didaktika e artit figurativ I, 2+2, 4 (semestra (pedagogji-klasor)	20x4x0.002=0.16
1.2.11	Didaktika e artit figurative II, 5 (semestra) (pedagogji-klasor)	30x4x0.002=0.24

1.3.1	Mentor i punimit të diplomës	2x0.2=0.4
1.3.2	Anëtar i komisionit për vlerësim ose mbrojtje të diplomave	26x0.2=5.2
2	Botime të dispensave për nevojat e studentëve	
2.1	Vizatim 2010	4
2.2	Histori Arti 2014	4
2.3	Loja Skenike 2014	4
2.4	Kostumografi 2015	4
2.5	Skenografi 2014	4
3.	Udhëheqës në punën praktike	Gjithësej
3.1	Shkolla fillore ‘‘Naim Frashëri’’-2012-2017, Tetovë 5 (semestra)	1.5
3.2	Shkolla fillore ‘‘Përparimi’’2012-2017, Reçic e madhe-Tetovë 5 (semestra)	1.5
3.3	Shkolla fillore ‘‘Istikball’’2012-2017, Tetovë 5 (semestra)	1.5
3.4	Shkolla fillore ‘‘Migjeni’’2014-2016 Tetovë 3 (semestra)	1.5
3.5	Shkolla fillore ‘‘Kirili Metodi’’ 2009-2011 Tetovë 2(semestra)	1.5

VEPRIMTARIA SHKENCORE-HULUMTUESE

Nr.	Emri i aktivitetit:	Pikët
4	Pjesëmarrës në projekte kombëtare shkencore	
4.1	Më 2004 pjesëmarrëse në projektin AKTIVITETE EKSTRAKURRIKULARE PËR SHKOLLA ME NXËNËS ETNIKISHT TË PËRZIER, organizuar nga Ministria e Kulturës së Republikës së Maqedonisë.	5
4.2	Më 2005 pjesëmarrëse në projektin „КРЕАТИВНА НАСТАВА И УЧЕЊЕ“, organizuar nga USAID.	5
4.3	Pjesëmarrës në javën e veçantë studimore, hulumtuese-shkencore realizuar me 06.03-10.03.2017, Gesellschaft zur Förderung der Zusammenarbeit mit albanischsprachigen Bildungsinstitutionen.	5
5.	Artikuj me rezultate shkencore origjinale, të publikuara në revistë	

	referente shkencore/profesionale me bord redaktues Impact Factor	
5.1	Revistë shkencore ndërkombtare, qendra për mirëkuptim dhe bashkpunim institucional, qmbi, centrum, 7/2017. (botuar në revisten centrum si dhe online) me punimin, “Postmodernizmi dhe simbioza e modës dhe dizajnit në instalacion”	6
5.2	Konferencën Ndërkombëtare Shkencore në Budva, Mali Zi, 2017 “The teacher of the future”, ku kam marrë pjesë me punimin shkencorë; “Apparel as attractiv aesthetic element in teaching” (botuar në revisten shkencore knowledge si dhe online)	6
6.	Artikuj me rezultate shkencore origjinale, të publikuara në revistë referente shkencore/profesionale me bord redaktues ndërkombëtar	
6.1.	Pajaziti,Valentina,2013 ”Research and education-challenges towards the future (icrae 2013)“,”Rëndësia e artit figurativ në edukimin estetik tek fëmijët” ISSN: 2308-0825,	5.4
6.2.	Pajaziti,Valentina, 2013 “Problemet socio-kulturore dhe sfidat e bashkëkohësisë“, me punimin shkencor: “Filozofia e instalacionit në artin bashkëkohor“	5.4
6.3.	Pajaziti,Valentina, 2014 “Shkenca dhe zhvillimi shoqëror“, organizuar në Shkup në Universitetin European”, “Fashion and design as challenge in science” ISBN 978-608-4574-62-0	5.4
6.4.	Pajaziti,Valentina, 2016 “Sfidat dhe perspektiva e arsimit bashkëkohor” “Freedom Of Aesthetic Education In Additional And Encouragement Creative In Teaching”(botuar në revisten shkencore PHILOSOPHICA Tetovë-2016).	5.4
6.5	Pajaziti,Valentina, 2014“Ballafaqimi me të kaluarën dhe rimendimi i paqës në ballkanin multikulturor“, “Karakterit socio-estetik i pikturës“ (botuar në revisten shkencore PHILOSOPHICA Tetovë-2015).	5.4
6.6	Pajaziti,Valentina, 2015 “Education in xxi century -conditions and perspectives”, “ Aesthetic education of educators as a future challenge”	5.4
6.7	Murati Sheherzada, Pajaziti Valentina, “The human rights situation in the Republik of Macedonia as a precondition for EU membership”. ISSN: 2308-0825	4.6

6.8	Idrizi Valdeta, Pajaziti Valentina “Vlerësimi formativ dhe ndikimi i informatës kthyesë në suksesin dhe të arriturat e nxënësve”.	4.6
7.	Artikuj me rezultate shkencore origjinale, të publikuara në revistë shkencore/profesionale	
7.1	“The teacher of the future” ku kam marrë pjesë me punimin shkencorë; “Apparel as attractiv aesthetic element in teaching” (botuar në revisten shkencore KNOWLEDGE	6
8	Pesëmarrje në takim shkencor/profesional me referat -prezentim oral	
8.1	2013, ka marrë pjesë në Konferencën Ndërkombëtare Shkencore: „Research and education-challenges towards the future (ICRAE 2013)“ në Shkodër – Shqipëri, si <i>autore</i> me punimin shkencor të botuar në formë elektronike (http://icrae2013.unishk.edu.al/icraecd2013/abstract.html), ”Rëndësia e artit figurativ në edukimin estetik tek fëmijët”	5.4
8.2	2014 ka marrë pjesë në Konferencën e katërt ndërkombëtare „Shkenca dhe zhvillimi shoqëror“, organizuar në Shkup në Universitetin European, si autore me temën: “Fashion and design as challenge in science” ISBN 978-608-4574-62-0 (Botuar në formë elektronike).	5.4
8.3	2013 ka marrë pjesë në Konferencën Ndërkombëtare Shkencore të Fakultetit Filozofik pranë Universitetit Shtetëror të Tetovës me temën Problemet socio-kulturore dhe sfidat e bashkëkohësisë, me punimin shkencor, “Filozofia e instalacionit në artin bashkëkohor”	5.4
9.	Abstrakt i botuar në librin e abstrakteve nga konferencat shkencore-Ndërkombëtare	
9.1	Valentina Pajaziti, ”Rëndësia e artit figurativ në edukimin estetik tek fëmijët” Konferencë Ndërkombëtare në Shkodër – Shqipëri, 24-25 maj 2013	1
9.2	Valentina Pajaziti “Filozofia e instalacionit në artin bashkëkohor” Konferencë Ndërkombëtare e Fakultetit Filozofik “18-19 tetor 2013	1
9.3	Valentina Pajaziti, “Fashion and design as challenge in science” Konferenca e katërt ndërkombëtare, organizuar në Shkup në Universitetin European, 9.05.2014	1

9.4	Valentina Pajaziti , “Freedom Of Aesthetic Education In Additional And Encouragement Creative In Teaching” Konferencën Ndërkombëtare organizuar nga të Fakultetit Filozofik pranë Universitetit Shtetëror të Tetovës 30-31 Tetor 2015	1
9.5	Valentina Pajaziti , “Karakter i Socio-Estetik i Pikturës”, Konferencën Ndërkombëtare Shkencore të Fakultetit Filozofik pranë Universitetit Shtetëror të Tetovës, 17-18 Tetor 2014	1
Gjithsej		

VEPRIMTARIA PROFESIONALE-APLIKATIVE

Nr. Rendor	Emri i aktivitetit:	Pikët
10	Pjesëmarrje në aktivitete promovuese të fakultetit	
10.1	Ditët e hapura, USHT, prezantim i programit studimor: Fakulteti filozofik-pedagogji, 2012	1
10.2	Ditët e hapura, USHT, prezantim i programit studimor: Fakulteti filozofik-pedagogji 2013	1
10.3	Ditët e hapura, USHT, prezantim i programit studimor , 2014	1
10.4	Ditët e hapura, USHT, prezantim i programit studimor , 2015	1
10.5	Ditët e hapura, USHT, prezantim i programit studimor 2016	1
10.6	Ditët e hapura, UT, prezantim i programit studimor 2017	1
Gjithsej		6

VEPRIMTARITË ME INTERES MË TË GJERË

Nr. Rendor	Emri i aktivitetit:	Pikët
11	Veprimtaritë artistike-projekte kryesore	
11.1	<i>Kostumografe</i> “Imprezari nga izmiri”, organizuar nga Ministria e Kulturës së Republikës së Maqedonisë më 2008 në Tetovë.	4

11.2	<i>Kostumografe “Alegretto Albania”, organizuar nga Ministria e Kulturës së Republikës së Maqedonisë si dhe Cosmofon më 2007 në Shkup.</i>	4
11.3	<i>Kostumografe “Vdekja aksidentale e një anarkisti”, organizuar nga Ministria e Kulturës së Republikës së Maqedonisë më 2008 në Tetovë.</i>	4
11.4	<i>Kostumografe “Çmendina”, organizuar nga Ministria e Kulturës së Republikës së Maqedonisë më 2006</i>	4
11.5	<i>Kostumografe “Dashuri, teatr dhe marrëzi të tjera”, organizuar nga Ministria e Kulturës së Republikës së Maqedonisë më 2012.</i>	4
11.6	<i>Kostumografe “Me grusht tehut të thikës”, organizuar nga Ministria e Kulturës së Republikës së Maqedonisë më 2013.</i>	4
12	Veprat artistike-profesionale	
12.1	Realizuese e sfiladës së parë të modës në Tetovë me temën: “Luks dhe ekstravagancë” më 2005 vetëfinansim	8
12.2	Ekspozitë personale: “Emocionet si motivim artistik” më 2011, me vetëfinansim.	8
12.3	Ekspozitë: “Refleksion” 2009“ Prishtinë, organizuar nga Ministria e Kulturës së Republikës së Kosovës.	2
12.4	Pjesmarrje në ekspozitë me rastin e “8 marsit”, Tetovë 2016 organizuar nga Kumuna e Tetovës	2
12.5	“Salloni dimëror“ Tetovë 2007, organizuar nga Ministria e Kulturës së Republikës së Maqedonisë.	2
12.6	Pjesmarrje në ekspozitë me rastin e “28 nëntorit” 2015 organizuar nga Kumuna e Tetovës	2
12.7	Ekspozita “Salloni pranveror“ Gostivar – 2013, organizuar nga Ministria e Kulturës së Republikës së Maqedonisë.	2
Gjithsej		

REFERENCAT PROFESIONALE TË KANDIDATIT PËR ZGJEDHJEN NË THIRRJEN	Pikë
VEPRIMTARIA MËSIMORE-ARSIMORE	109.79 6
VEPRIMTARIA SHKENCORE-HULUMTUESE	90.4
VEPRIMTARIA PROFESIONALE-APLIKATIVE	6
VEPRIMTARITË ME INTERES MË TË GJERË	50
Gjithsej	256.19 6

Tetovë
Data:19.03.2018

Anëtarët e Komisionit recensues:

Prof.dr. Fehim Huskoviç (kryetar)

Prof.ord. Reshat Ameti (anëtar)

Prof.dr.Fadbi Osmani (anëtar)

R E F E R A T

**PËR ZGJEDHJENE NJËMËSIMDHËNËSI NË THIRRJEN MËSIMORE-SHKENCORE
PROFESOR INORDINAR PËR LËMINË E PEDAGOGJISË NË FAKULTETIN PEDAGOGJIK
NË UNIVERSITETIN E TETOVËS**

Në bazë të Propozim vendimit të **Këshillit Mësimor-Shkencor të Fakultetit Pedagogjik**, të Universitetit të Tetovës, **me nr. 24-113/1** të datës **09.02.2018**, lidhur me Konkursin, për zgjedhjen- rizgjedhjen e mësimdhënësve në Universitetin e Tetovës në të gjitha thirrjet mësimore-shkencore të shpallur në gazetën ditore “Koha” dhe “Nova Makedonija”, si dhe në web-faqen zyrtare të Universitetit www.unite.edu.mk të datës **31.01.2018**, **Këshilli i Rektoratit**, në mbledhjen e mbajtur më **27.02.2018**, mori **vendim nr.02-1139/2** të datës **06.03.2018** dhe formoi Komisionin recensues në përbërje:

Dr. Xheladin Murati (kryetar) , në thirrje profesor ordinar, doktor i shkencave pedagogjike,

Dr. Rabije Murati (anëtar), në thirrje profesor inordinar, doktor i shkencave pedagogjike dhe

Dr. Myqereme Rusi (anëtar), profesor ordinar, doktor i shkencave psikologjike

Në konkursin e shpallur për zgjedhjen e një mësimdhënësi në të gjitha thirrjet mësimor-shkencore për lëndët Hyrje në pedagogji, Pedagogjia e përgjithshme, Komunikologjia pedagogjike, Pedagogjia (në programin studimor Gjuhë dhe Letërsi Angleze) , në afatin e paraparë është paraqitur kandidatja Doc.dr.Lulzime Lutfiu Kadriu.

Komisioni në përbërje të plotë, si më sipër, pasi e kontrollloi materialin e konkursit, titullit të lartëpërmendur i paraqet këtë:

R A P O R T

1.Të dhënat biografike dhe veprimtaria mësimore-shkencore e kandidatës:

Dr. Lulzime Lutfiu – Kadriu u lind më 24.06.1975 në f.Zhubrinë të Kërçovës. Shkollimin fillor e kryen me sukses të shkëlqyeshëm në sh.f.„Sande Shterjoski”– Kërçovë, kurse të mesmen, gjimnazin „Mirko Mileski”, drejtimi matematiko-natyror, e kryen po kështu me sukses të shkëlqyeshëm në Kërçovë. Në vitin akademik 1997/ 98

ajo u diplomua në Universitetin “Sh. Kirili dhe Metodi”, në Fakultetin Filozofik - Instituti i Pedagogjisë, në Shkup, duke mbrojtur temën „Metodat dhe teknikat e punës këshilluese me prindërit” me notën 10 dhe duke fituar kualifikimin - pedagoge e diplomuar.

Prej 2000/01 e deri më 2007 ka ndjekur dhe i ka kryer studimet pasuniversitare në Universitetin “Sh.Kirili dhe Metodi”, në Fakultetin Filozofik - Instituti i Pedagogjisë, në Shkup.

Gradën shkencore “Magjistre e shkencave pedagogjike” e ka fituar më 28.11.2007 në temën:” Komunikimi midis mësimdhënësit dhe nxënësit si faktor i punës edukative në shkollë” nën udhëheqjen e Profesoreshës së shquar Prof.dr. Marija Kostova .

Në vitin 2008 i fillon studimet e doktoratës në Universitetin “Sh.Kirili dhe Metodi”, në Fakultetin Filozofik - Instituti i Pedagogjisë, në Shkup, kurse më 2012 mbron me sukses disertacionin e doktoratës me temë: “Mësimi kreativ - simbiozë risish”, nën udhëheqjen e Prof.Dr. Snezhana Adamçevska dhe fitoi gradën shkencore “Doktore e Shkencave Pedagogjike”.

Dr. Lulzime Lutfiu Kadriu është Docente në Universitetin e Tetovës, Fakultetin Pedagogjik, program studimor: Klasor, Profesional dhe Parashkollor. Në opinionin e gjerë akademik dhe shkencor njihet si një punëtoresh shkencore mjaft produktive dhe mësimdhënëse tepër e zellshme. Studimet e saj tani më janë të njohura për fushën e pedagogjisë dhe më gjerë. Përveç studimit të çështjeve të përgjithshme pedagogjike , ajo tregon interesim të veçantë për çështjet e kreativitetit në mësim , krijimtarisë dhe kulturës së komunikimit në shkollë dhe jashtë saj .

2.Përvoja (eksperiencia) profesionale :

- Në vitet 1999-2004 punon si **pedagoge në shkollën fillore “Mito Gurra”** fsh. Strellcë, Kërçovë,

Prej 4.10. 1999 – 16 .07. 2004 ajo është e angazhuar si **bashkëpunëtoresh e jashtme** për lëndët :Pedagogjia parashkollore; Metodika e gjuhës shqipe; Didaktika, në Fakultetin Pedagogjik, Universiteti i Tetovës.

- Më 17.07. 2004 dr.Lulzime Lutfiu Kadriu themelon marrëdhënie pune të rregullt si **asistente e re** në Universitetin Shtetëror të Tetovës në Fakultetin e Shkencave Humane dhe të Arteve – programi studimor Pedagogji-Psikologji për lëndët: Teoritë e edukimit I dhe II, Komunikologjia pedagogjike.

-Më 27.06.2008 ajo zgjidhet në titullin akademik **asistente** në Universitetin Shtetëror të Tetovës, Fakulteti i Shkencave Humane dhe i Arteve, për lëndët: Teoritë e edukimit I dhe II, Komunikologjia pedagogjike.

Në shkurt 2013 - zgjidhet në thirrjen mësimore – **docente** – programit studimor Pedagogji: drejtimi klasor dhe profesional në Universitetin Shtetëror të Tetovës- Fakulteti Filozofik, për lëndët:Teoria e edukimit I,II; dhe Komunikologji pedagogjike ; Pedagogjia e përgjithshme (Gjuhë dhe letërsi angleze) ;

Ne vitet 2012-2014 dr. Lulzime Lutfiu – Kadriu kryen detyrën u.d.Shef i programit studimor Pedagogji: Grupi klasor dhe profesional në Fakultetin Filozofik - Universitetin Shtetëror të Tetovës.

Në vitin 2016/2017 është angazhuar në Kolegjin Dardania - Prishtinë, R. e Kosovës, ku në Fakultetin e Shkencave Sociale dhe të Administratës Publike ka ligjëruar lëndët: Riedukim dhe risocializim , Komunikimi profesional , Metodologjia e hulumtimit në punën sociale dhe Bazat themelore të kërkimit shkencor .

Në vitet 2012-2017 realizon me sukses ligjëratat dhe ushtrimet ne lëndet: Hyrje në pedagogji, Pedagogji e përgjithshme, Komunikologji pedagogjike; Teoria e edukatës – drejtimi Profesional; Pedagogji në Fakultetin Filologjik Tetovë, Pedagogji, Didaktikë në Fakultetin Filologjik – Gjuhë dhe letërsi angleze dhe Gj.L. Gjermane – Kërçovë; Teoria e edukatës - Programi studimor: Psikologji; Pedagogji ne FSHMN (Kimi , Biologji, Matematikë) dhe në Programin studimor Filologji orientale drejtimi gjuhë dhe letërsi turke dhe gjuhë dhe letërsi arabe.

Në vitin 2012-2013 realizon me sukses ligjëratat në lëndën Projekti Ideor në programin studimor Mësim besimi fetar – Specializim, Programi studimor Filologji Orientale - , Fakulteti Filozofik - USHT.

Në vitet 2013/2014 dhe 2014/2015 ligjëron lëndët Hulumtime Aksionale, Trajnimi dhe persosja profesionale e arsimtarit në ciklin e II-të në Master program studimor Pedagogji, Fakulteti Filozofik –USHT.

Në vitet 2014 /2015 dhe 2016/2017 ligjëron lëndën e Pedagogjise në programin studimor Rikualifikim, Fakulteti Filozofik –USHT.

1999-2017 – vazhdimësi në studime e në punë dhe përvoja nga fusha e pedagogjisë.

Angazhime tjera :

- 2013/2014 - anëtare e komisionit të grupit punues në përpilimin e Elaboratit për Rikualifikim Pedagogjik në MASH – BZHA.
- 2013 – koordinatorë për përpilimin e Planprogramit për ciklin e I-rë , Programi studimor Pedagogji , drejtimi Klasor dhe Profesional.
- 2013/2014 - anëtare e komisionit të grupit punues në përpilimin e Elaboratit për ciklin e dytë - Master drejtimi – Pedagogji .

- 2013/14- anëtare e këshillit organizativ të konferencës së parë shkencore në F.Filozofik–USHT:
- 2013/14 -anëtare e komisionit recenzues të revistës „Filozofika” në F.Filozofik- USHT ;
- 2013 / 2014 moderatore – udheheqëse e sesionit të konferencës së parë shkencore ndërkombëtare në USHT , Fakultetin Filozofik , programi studimor Pedagogji .
- 2014 / 2015anëtare e bordit shkencor të konferencës së dytë shkencore ndërkombëtare në F.Filozofik të USHT-së .
- 2012 / 2017 mentore në komisionin për mbrojtje të punimit të diplomës (mbi 70 kandidatëve) në ciklin e parë të studimeve në Fakultetin Filozofik, Pedagogji, USHT .
- 2012 / 2017 anëtare dhe kryetare e komisionit në mbrojtje të punimit të diplomës. (mbi 30 kandidatë), në Fakultetin Filozofik, Pedagogji, USHT .
- 2014/ 2016 mentore në komisionin për mbrojtje të magjistraturës në ciklin e dytë, (9 - të kandidatë) në Fakultetin Filozofik, Pedagogji , USHT .
- 2014-2017 kryetare dhe anëtare e komisionit në mbrojtje të punimit të magjistraturës (20-të kandidatë) në ciklin e dytë drejtimi Pedagogji në Fakultetin Filozofik, Pedagogji,USHT .
- Recensuse e librit „Tendencat evropiane në arsim “ nga autori Prof.dr. Xheladin Murati , botoi dhe shtypi : Luma grafik , Tetovë, 2014.
- Recensuse e librit „Pedagogjia Shkollore “ nga autorët Prof.dr. Xheladin Murati dhe Ardita Ceka Tahiri, botoi dhe shtypi sh.b. : Çabej , Tetovë, 2017.
- Përveç gjuhës shqipe, Dr. Lulzime Lutfiu Kadriu njeh rrjedhshëm edhe gjuhën maqedone, serbokroate, ndërsa për nevoja shkencore gjuhën angleze dhe bullgare.

3.Pjesëmarrja në trajnime dhe Projekte :

Në aktivitetin shkenor-profesional dr. Lulzime Lutfiu Kadriu ka marrë pjesë në një sere trajnimesh e projektesh si:

-Social Skills and Responsibilities of Teachers and Professional Staff in a Multi-Ethnic Education System Mësimi interkulturore, integrimin e nxënësve në grupet e marginalizuara në sistemin arsimor, aftësitë e komunikimit, aftësia për zgjidhjen e konflikteve,...Strumica 16 to 18 December 2011;

Përdorimi i programeve në punën në zyrë dhe përdorimi i internetit, Bazat e konceptit të TIK udhëheqja me folla (failovi) Word, Excel. Power Point, Shfrytëzimi i internetit, Janar- Shkurt 2012;

-„Aplikimi i komunikimit inter- kulturor në lëndët e Metodologjisë”, Puntori multikulturore – organizuar në UEJL – Tetovë, UEJL Nëntor 2011;

- Qendra Edukative „ Qendra Algoritam “- Shkup ,Vlerësimi i diturive dhe aftësive të nxënësve me aplikimin e taksonomisë së Blumit . (Dhjetor,2014-Mapт , 2015).

- Universiteti Shtetëror i Tetovës, Fakulteti Filozofik Programi studimor Pedagogji . Java a veçante, 6-10 Mars, 2017, Tema: ” IDENTIFIKIMI PROFESIONAL I MËSUESIT “, në botim libri “Mësuesi i ri i shekullit 21”.

4.Anëtare e asociacioneve:

- Prej vitit 1999 është anëtare e Lidhjes së pedagogëve të Maqedonisë – dega e Kërçovës.
- Nga viti 2002 është anëtare e Lidhjes së gruas shqiptare – dega Kërçovë dhe mban ligjërata lidhur me amancipimin e femrës shqiptare.

Të dhëna plotësuese:

Punim praktik - Projekt hulumtues: Kontrollimi i shpejtësisë së leximit në klasën e parë - sh.f. "Milto Gurra", Kërçovë.

Punim teorik me temë: Edukata si veprimtari (kuptimi, rëndësia, karakteristikat) dhe realizimi i saj nëpërmjet planit dhe programit të veprimtarisë edukativo-arsimore në shkollë – MASH.

5.Pjesmarrja në konferenca Kombëtare e Nderkombetare shkencore

Në veprimtarinë e saj si docente dr. Lulzime Lutfiu Kadriu ka qenë aktivisht e angazhuar në afirmimin e vlerave të mirëfillta shkencore-profesionale nga fusha e disiplinave pedagogjike. Me kontributet e saj ka marrë pjesë në disa konferenca shkencore në nivel kombëtar e ndërkombëtar.

1.The professor as a promoter in successful communication with students fifth scientific congress:„ education for a human society``- book 2010 University „sts. Cyril and Methodius,, Skopje Faculty of Pedagogy,, St. Kliment Ohridski``, Skopje - Konferencë ndërkombëtare me karakter shkencor,28-29.05.2010,Ohër.(autore)(Çertifikatë)

2.“Креативната работа на старите лица во функција на активно стареење

2012, Shkup - Konferencë ndërkombëtare me karakter shkencor: „Активно стареење меѓугенерациска солидарност,,(autore)

3.,„Учеството на старите лица во општеството и нивните доживувања во постпенсоналниот период 2012, Shkup Konferencë ndërkombëtare me karakter shkencor: „Активно стареење меѓугенерациска солидарност,,(bashkautore)

4. **Lulzime Lutfiu Kadriu & Hana Rusi Saliu, Promoting skills and abilities – the student as a crucial subject in creative learning**, The 1 international conference on “Research and Education-Challenges Towards The Future” ICRE,Maj,2013, Shkodër, R. e Shqiperisë.(Çertifikatë).

5. **Hana Rusi Saliu, Myqereme Rusi & Lulzime Lutfiu Kadriu, Critical thinking skills and the way of their development**, The 1 international conference on “Research and Education-Challenges Towards The Future” ICRE. Maj,2013, Shkoder, R. e Shqiperisë. (Çertifikatë).

6. **Bekim Kadriu, Lulzime Lutfiu Kadriu Igballe Miftari**,„The needs of education (license) in the management of changes in schools” The 1 international conference on “Research and Education-Challenges Towards The Future” ICRE. 2013, Shkodër, R. e Shqiperisë. .(Çertifikatë).

7. **Lulzime Lutfiu Kadriu**, Igballe Miftari, “Innovations- an assumption for the development of creative teaching, “International conference „INNOVATIONS,CHALLENGES AND TENDENCIE IN POST MODERN EDUKATION” Trakia University – Faculty of education , Stara Zagora , Bulgaria , 2013. (Çertifikatë).

8. **Lulzime Lutfiu Kadriu** Komunikimi ndermjet arsimtarit dhe nxënësit faktor i rëndësishëm në realizimin e punës edukative”, „ Teacher- student communication: a crucial factor in the realisation of the educational process and teaching”International Scientific conference“Socio-cultural issues and challenges of contemporaneity”,18-19.10.2013,, State University of Tetova , Maqedoni f. 32p.33.(Çertifikatë).

9. **Lulzime Lutfiu Kadriu, Bekim Kadriu**,„Management education as a strategy for changes in schools”, “Менаџерското образование како стратегија за промени во училиштето”, Fourth International Scientific Conference,„The Science and the Social Development”Konferencën e katërt ndërkombëtare shkencore,,Shkenca dhe zhvillimi shoqëror””Organizuar nga Universitetin European,09 maj 2014,Shkup, Maqedoni p.44,45. (Çertifikatë).

10. **Lulzime Lutfiu Kadriu,Abdulla Ballhysa**, „Zhvillimi i kultures së komunikimit te nxënësit – faktor qenësor në marrëdhëniet ndërnjerëzore,” “The development of the culture of communication in pupils –an important

factor in the interethnic relationship” **2nd International Conference of the Philosophic Faculty SICPHF 2014, 17-18 October 2014, State University of Tetova, Tetova, Macedonia p.30.**(Çertifikatë).

11. **Abdulla Ballhysa, Lulzime Lutfiu Kadriu**, “Group Work- an important factor for interethnic education”, “Puna në grup-faktor i rëndësishëm për edukimin ndëretnik”, **2nd International Conference of the Philosophic Faculty SICPHF 2014, 17-18 October 2014, State University of Tetova, p.31, Macedonia.**(Çertifikatë).

12. **Lulzime Lutfiu Kadriu** Creativity in Teaching- An innovative Approach in Education” „Kreativiteti në mësimdhënie si qasje inovative në arsim “9th International Balkan education and Science Congress, **16 -18 October, 2014 /EDIRNE** , Trakya University Faculty of Education , Edirne – **Turkey** Bildiri ID:292**p.193.** (Çertifikatë).

13. **Lulzime Lutfiu Kadriu, Abdulla Ballhysa** “Pupils’attitudes in solving the problem of communicating with the teacher”, “Qëndrimi nxënësit në zgjidhjen e problemit gjatë komunikimit me mësuesin”, 9th Annual International Conference (AIS) „Law and Values in Contemporary Society “**N^o AIS Tirana 2014-8501 p. 14** Organizers: Albanian Institute of Sociology(AIS)ALBSA, Faculty of education, University „Aleksander Moisiu “Durres, UET, **21-22 November 2014, Tirana- Albania.** (Çertifikatë).

14. **Lulzime Lutfiu Kadriu**, “Formimi i shkathtësive të nxënësit në mësimdhënien kreative”, Konferenca e 2-të Ndërkombëtare Arsimore e Shqipërisë, „ DIMENSIONI EUROPIAN NE KONTEKSTIN KOMBETAR “ **AICE Tiranë, 14-15 Nëntor 2014, Shqiperi.** (Çertifikatë).

